



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.120

21 nëntor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.24, datë 10.11.2006

Me objekt shfuqizimin e akteve normative të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 10.11.2005 “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike”; nr.3, datë 23.11.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”; nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe interpretimi përfundimtar i nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4813

Vendim i GJK
nr.25, datë 10.11.2006

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.49, datë 22.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....

4819

Vendim i ERE
nr.80, datë 14.11.2006

Për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamiljare.....

4821

VENDIM
Nr.24, datë 10.11.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 16.2.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.17 Akti që i përket:

KËRKUES: Një grup prej 33 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ylli Manjani, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Dritan Devole e Idar Bistri, me autorizim.
2. Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, Andi Toma e Marin Biçoku, me autorizim.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përfaqësuar nga Alfred Rushaj e Zamir Stefani, me autorizim.
4. Bashkia e Tiranës, përfaqësuar nga Natasha Kondi e Migena Vishko, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i akteve normative të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 10.11.2005 “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike”; nr.3, datë 23.11.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”; nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”; si dhe interpretimi përfundimtar i nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit kanë parashtruar, ndërmjet të tjerave, këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të akteve normative të sipërcituara:

- Aktet normative me fuqinë e ligjit nuk janë nxjerrë në kushtet e urgjencës apo të një boshllëku legjislativ dhe nuk kanë karakter të përkohshëm, siç parashikon neni 101 i Kushtetutës.
- Këto akte normative kanë krijuar pasoja më parë se të botohen në Fletoren Zyrtare.
- Akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”” cenon rëndë autonominë vendore dhe bie ndesh me nenet 13, 95, 108, 114 të Kushtetutës. Ky akt normativ e ka humbur fuqinë që nga fillimi, pasi nuk është miratuar nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Lidhur me kërkesën për interpretimin e nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi ka nënvizuar si çështje me interes: kuptimin e nevojës dhe urgjencës, fuqinë juridike të akteve normative me fuqinë e ligjit, kohën e hyrjes në fuqi të tyre, afatet e shqyrtimit të këtyre akteve nga Kuvendi i Shqipërisë dhe efektet e këtij shqyrtimi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesit e kërkuesve dhe të Bashkisë së Tiranës, që kërkuan pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e Kuvendit, të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Këshilli i Ministrave, bazuar në nenin 101 të Kushtetutës, ka miratuar aktet normative me fuqinë e ligjit nr.2, datë 10.11.2005 “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike”; nr.3, datë 23.11.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”; nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën””.

33 deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe kërkojnë shpalljen si të papajtueshme me Kushtetutën të akteve normative me fuqinë e ligjit të sipërcituara, si dhe interpretimin përfundimtar të nenit 101 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese çmon se shqyrtimi i kësaj çështjeje kërkon që paraprakisht të interpretohen elementet përbërëse të nenin 101 të Kushtetutës, të cilat kërkuar si ka pretenduar si shkaqe për antikushtetutshmërinë e akteve normative me fuqinë e ligjit, objekt të këtij gjykimi.

Rëndësi të drejtpërdrejtë në gjykimin e çështjes ka dhe parimi kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës. Ky parim ndihmon që pushteti të shpërndahet në disa mbajtës, me funksione e detyra të ndryshme, të mirëpërcaktuara nga Kushtetuta, si dhe mundëson bashkëveprimin midis tyre, me qëllim unitetin në veprimin shtetëror.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke e njohur dhe sanksionuar përqendrimin e pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë ka lejuar, si raste përjashtimore, nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese. Një nga përjashtimet është ai i parashikuar nga neni 101 i Kushtetutës, që i njeh të drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit. Përdorimi i këtij instrumenti ligjvënës mbetet në vlerësimin e Këshillit të Ministrave, por çmohet se përdorimi i tij, gjërësisht dhe jo në kushtet e parashikuara nga Kushtetuta, do të cenonte pavarësinë e pushtetit legjislativ dhe karakterin demokratik të shtetit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Përjashtime të tilla janë të njohura edhe nga kushtetutat e shteteve të tjera demokratike, ku konstatohet se është lejuar transferimi i ndonjë kompetence që i përket pushtetit legjislativ drejt ekzekutivit. Ky lejim ka mundësuar zhvillime të konsiderueshme doktrinale dhe gjyqësore, të cilat do të mbahen në konsideratë nga kjo Gjykatë gjatë interpretimit të elementeve të nenit 101 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se zgjidhja e çështjes në shqyrtim është e lidhur me kuptimin e elementeve të mëposhtme:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit.
2. Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit.
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre.
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

I

1. Për shqyrtimin e kësaj çështjeje, duhet të marrin përgjigje një sërë pyetjesh që lidhen me kuptimin kushtetues të termave nevojë dhe urgjencë, me domosdoshmërinë e pranisë së këtyre dy elementeve, me pasojat që mund t'i vijnë aktit normativ për shkak të mosekzistencës së tyre, me organet që kanë të drejtën për të verifikuar nevojën dhe urgjencën konkrete, të cilat kanë shërbyer si bazë për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit.

Gjykata Kushtetuese çmon se nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Kuptimi i tyre është autonom, i lidhur me tërësinë e përmbajtjes së dispozitës dhe me parimet bazë që përshkojnë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmendim: fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit, ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publikë ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot.

Nevoja dhe urgjenca duhen kuptuar si parakushte të domosdoshme me pasojë pavlefshmërinë e aktit normativ me fuqinë e ligjit. Mungesa e tyre, shndërrohet në ves të legjitimitetit kushtetues të qeverisë për nxjerrjen e aktit normativ dhe në vijim, në ves të ligjit që e ka miratuar atë. Duke qenë kushte paraprake, nevoja dhe urgjenca duhet të jenë vërtetuar se ekzistojnë përpara momentit të marrjes së iniciativës nga qeveria për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit.

Këto dy kushte duhet të jenë gjithashtu prezente, të lidhura e të ndërvarura e në momentin kur nxirret akti normativ me fuqinë e ligjit. Nëse ekziston nevoja për nxjerrjen e një ligji, por pa ndonjë urgjencë të dukshme, qeveria nuk mund të ndërmarrë nismën për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, pasi kjo do të përbente një detyrë të pushtetit legjislativ. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi legjislativ, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, inisiativa ligjvënëse mund t'i kalojë qeverisë. Nëse nuk do të vlerësohej ky aspekt, qeveria do të merrte, pa të drejtë, funksionet ligjvënëse të Kuvendit. Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 të saj, ka lejuar që pushteti ekzekutiv të mund të miratojë akte që kanë të njëjtën fuqi si ligjet vetëm kur rasti shfaqet si i jashtëzakonshëm dhe nevoja e urgjenca bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi.

Nga ana tjetër, elementi urgjencë nuk mund të ekzistojë në vetvete pa nevojën, sepse urgjenca tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa nevoja tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Prania e domosdoshme e të dy elementeve

rezulton edhe nga analiza gjuhësore e tekstit të nenit 101 të Kushtetutës. Lidhëza “dhe” si në çdo rast, kërkon praninë e njëkohshme të të dy elementeve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore janë përdorur lidhëset “ose”/ “apo”.

Kuptimin e tyre të vërtetë termit nevojë dhe urgjencë e manifestojnë në kuadër të situatës të rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre. Nga kuptimi i përmbajtjes së nenit 101 të Kushtetutës rezulton se vlerësimin e parë faktik dhe substancial të këtyre elementeve i përket ta bëjë qeveria. Ajo nuk mund të ndërmarrë një nismë, për nxjerrjen e një akti normativ me fuqinë e ligjit, pa vlerësuar më parë rrethanat e krijuara që kanë shkaktuar nevojë dhe urgjencë. Natyra e vlerësimit që bën ky organ është faktik dhe juridik.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se prania e nevojës dhe urgjencës në kushtet e nxjerrjes së një akti normativ me fuqinë e ligjit, është e lidhur me ekzistencën e vetë normës. Këtë opinion ka shprehur dhe jurisprudenca kushtetuese ndërkombëtare¹ duke vlerësuar se ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ që ka fuqinë e ligjit.

Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese vlerëson se Qeveria është e detyruar të shpjegojë dhe argumentojë nevojën dhe urgjencën konkrete që e kanë detyruar të nxjerrë aktin normativ me fuqinë e ligjit. Ky detyrim ka karakter formal dhe substancial. Shpjegimin, qeveria është e detyruar ta pasqyrojë në përmbajtjen e çdo akti normativ me fuqinë e ligjit që nxjerr, minimalisht në preambulën e tij.

2. Akti normativ me fuqinë e ligjit vepron për një periudhë kohe maksimalisht 45 ditë. Përkohshmëria e kësaj norme lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Nëse akti nuk miratohet nga Kuvendi apo nuk merret në shqyrtim prej tij, me kalimin e periudhës 45-ditore, ai jo vetëm nuk prodhon më efekte për të ardhmen, por, njëkohësisht, humbet fuqinë që nga fillimi.

Ligji, si akt normativ, nuk e ka si karakteristikë të domosdoshme përkohshmërinë. Ai, pasi hyn në fuqi, bëhet pjesë konstante e korpusit të legjislacionit, me përjashtim të rasteve kur vetë Kuvendi i cakton një afat kohor fuqisë së tij. Në këtë mënyrë, ligji që miraton aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e zëvendësuar këtë akt pas miratimit, nuk shoqërohet me kufizim kohor të fuqisë së tij. Gjykata Kushtetuese vlerëson se shprehja “masa të përkohshme”, në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar e lidhur vetëm me fuqinë provizore, maksimumi 45-ditëshe, të aktit normativ me fuqinë e ligjit që i përmban ato masa dhe jo me fuqinë juridike të ligjit që e ka miratuar atë.

3. Akti normativ me fuqinë e ligjit është ligj në kuptimin material të termit, por jo në kuptimin formal të tij. Ai, në thelb, rregullon marrëdhënie shoqërore të rëndësishme që meritojnë trajtim me ligj nga Kuvendi, por kur vërtetohet prania e nevojës dhe e urgjencës, Kushtetuta lejon që iniciativën ligjvënëse, në këtë rast, ta kryejë Këshilli i Ministrave. Kuvendi ruan të drejtën e vlerësimit përfundimtar të këtij akti dhe, nëse e miraton atë, e kthen në ligj edhe në kuptimin formal. Gjykata Kushtetuese çmon se fuqia juridike e aktit normativ me fuqinë e ligjit është e barabartë me fuqinë e ligjit që nga momenti i nxjerrjes së tij, sepse kjo vlerë e normës përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike që gjën rregullim në të dhe jo nga organi që e ka miratuar. Fuqia juridike është element i pandashëm i përmbajtjes së normës.

Hyrja në fuqi e aktit normativ me fuqinë e ligjit dallon nga hyrja në fuqi e ligjit, të cilën Gjykata Kushtetuese e ka interpretuar qartë, me vendimin e saj nr.47, datë 7.7.1999.² Për të interpretuar këtë aspekt të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese çmon se duhen mbajtur parasysh përmbajtja dhe specifikat e nenit 101 të Kushtetutës. Elementet të tilla, si nevoja dhe urgjenca, tregojnë se aktet në fjalë duhet të hyjnë në fuqi menjëherë. Këto elemente, që qëndrojnë në bazë të transferimit kushtetues të së drejtës së nxjerrjes së aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi drejt Këshillit të Ministrave, do të zhvehtësoheshin nëse, për hyrjen në fuqi të tyre, do të duhet të respektohen, detyrimisht, të gjitha afatet dhe procedurat e parashikuara nga neni 117 i Kushtetutës. Nga ana tjetër, përmbajtja e pjesës së dytë të dispozitës kushtetuese në shqyrtim, ku thuhet: “Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”, tregon qartë se ato hyjnë në fuqi menjëherë. Me një interpretim *a contrario* të kësaj fjalie, kuptohet se aktet normative me fuqinë e ligjit duhet ta disponojnë fuqinë juridike që nga krijimi i tyre, me qëllim që të ekzistojë mundësia për ta humbur atë, po nga fillimi, kur nuk miratohen prej Kuvendit, si dhe kur kalon afati 45-ditor pa u marrë në shqyrtim prej tij.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese çmon gjithashtu, se njoftimi publik i aktit normativ me fuqinë e ligjit është detyrim kushtetues për organin që e nxjerr atë. Megjithatë, bërja publike e këtyre akteve nuk ka si domosdoshmëri botimin në Fletoren Zyrtare. Këshilli i Ministrave, për këtë qëllim, mund të përdorë, në funksion të kohës që ka në dispozicion, krahas botimit në Fletoren Zyrtare dhe komunikimin zyrtar

¹ Gjykata Kushtetuese Italiane, vendimi nr.29, datë 12-27.01.1995, publikuar në internet në faqen përkatëse të Gjykatës Kushtetuese Italiane.

Shënim plotësues: rregullimi kushtetues i dekretligjit, sipas nenit 77 të Kushtetutës Italiane, është shumë i ngjashëm me rregullimin e aktit normativ qeveritar të parashikuar nga neni 101i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

² Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (1997-1999), fq. 279-280

me mjete të tjera të përshtatshme, njoftimin me anë të mediave, apo mjete të tjera si këto. Pavarësisht nga forma e përzgjedhur për komunikimin publik, njoftimi duhet të mbërijë detyrimisht në adresë të subjekteve që lidhen me të drejtat e detyrimet që krijon akti normativ me fuqinë e ligjit, me qëllim që ata të mos cenohen.

4. Lidhur me çështjen e miratimit nga Kuvendi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, paraqet interes sqarimi i elementeve të tilla, si forma juridike me të cilën duhet të shprehet vullneti i Kuvendit për këtë qëllim, kompetencat e këtij organi lidhur me vlerësimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit të nxjerrë nga qeveria, si dhe karakteri i shqyrtimit që ky organ i bën aktit normativ të qeverisë.

Pavarësisht nga përmbajtja e vullnetit përfundimtar të Kuvendit ndaj një akti normativ me fuqinë e ligjit, të nxjerrë nga qeveria, Gjykata Kushtetuese çmon se vlerësimin e tij ky organ është i detyruar ta pasqyrojë vetëm me anë të një ligji. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit, të nxjerrë nga qeveria, dhe dhënia fuqi të mëtejshme atij nuk mund të bëhet veçse me anë të një norme që ka të njëjtat vlera, pra me ligj.

Kuvendi i Shqipërisë është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Duke përdorur termin “miraton”, dokumenti themelor i shtetit ka parasysh vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe shprehjen e mendimit përfundimtar nga organi vlerësues lidhur me aktin që shqyrton. Natyra e këtij vlerësimi është juridike, por dhe politike. Kuvendi, nëpërmjet mazhorancës, shpreh qëndrimin e tij politik ndaj veprimit ligjvënës të qeverisë, por në të njëjtën kohë, si një organ i ngarkuar për miratimin e ligjeve, kontrollon dhe kushtetutshmërinë e akteve normative të nxjerra dhe përputhjen e tyre me dispozitat e tjera ligjore. Vlerësimi dhe kontrolli i Kuvendit mbi aktin normativ me fuqinë e ligjit bazohet në faktin se pushteti ekzekutiv, në këtë rast, ushtron përjashtimisht një funksion ligjvënës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson gjithashtu se Kuvendi disponon tagra të plota për të zgjedhur një nga tre alternativat e mëposhtme: të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave; ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë; të heshtë derisa të plotësohet afati 45-ditor, që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për t’u shprehur lidhur me aktin. Alternativa e zgjedhur nga Kuvendi lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me perspektivën e mëtejshme të normës. Akti normativ me fuqinë e ligjit do të vazhdojë të prodhojë efekte, nëse miratohet, njësoj si gjithë ligjet e tjera, por ai do të humbasë fuqinë juridike që nga fillimi dhe do të konsiderohet se nuk ka ekzistuar kurrë nëse Kuvendi nuk e miraton ose lejon të kalojë afati 45-ditor pa u shprehur në mënyrë përfundimtare për të. Çdo lloj ndërhyrjeje nga ana e Kuvendit pas kalimit të këtij afati është e pavlefshme, pasi praktikisht nuk ekziston më objekti ndaj të cilit mund të bëhet vlerësim. Në mënyrë të qartë Kushtetuta e ka përcaktuar afatin 45-ditor si një afat prekluziv që nuk mund të zgjatet për asnjë lloj arsyeje, nga asnjë autoritet. Përfundimi i këtij afati sjell pasoja të menjëhershme për aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e lënë atë pa fuqi që nga fillimi.

Përsa i takon natyrës së shqyrtimit nga Kuvendi të aktit normativ me fuqinë e ligjit, Gjykata Kushtetuese vlerëson se ai është dhe i karakterit substancial. Përpara miratimit ose mosmiratimit të normës së nxjerrë nga Këshilli i Ministrave, Kuvendi e shqyrton atë për ta vlerësuar si në formë, ashtu dhe në përmbajtje. Ai shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata Kushtetuese përfaqëson gjithashtu një autoritet që ka kompetencë të vlerësojë këto akte në përgjithësi dhe nevojën e urgjencën si elemente të veçanta të tyre, por vetëm nëse një prej subjekteve të legjitimuara i është drejtuar me kërkesë për këtë qëllim.

II.

Bazuar në konsideratat e mësipërme, Gjykata Kushtetuese bën vlerësimin konkret të kushtetutshmërisë së akteve normative me fuqinë e ligjit, që janë paraqitur për shqyrtim përpara saj.

Nga provat e administruara gjatë seancës plenare, si dhe nga shpjegimet e palëve pjesëmarrëse, rezultoi e provuar se aktet normative nr.2, datë 10.11.2005 “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike” dhe nr.3, datë 23.11.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik” të ndryshuar”, janë nxjerrë nga Këshilli i Ministrave në kushte të nevojës dhe urgjencës. Në momentin e nxjerrjes së këtyre akteve nga qeveria vendi ndodhej në kushtet e një thatësire të tejzgatur, krijuar nga mungesa e reshjeve, gjë që kishte sjellë si pasojë rënie të ndjeshme të nivelit të ujit në liqenet që furnizojnë hidrocentralet e vendit. Kjo situatë tregonte dukshëm rrezikun e krijimit të pamundësisë për furnizim me energji elektrike të vendit në një të ardhme të shpejtë. Gjendja e krijuar kërkonte ndërhyrje të shtetit për marrjen e masave urgjente. Plotësimi i nevojave për energji elektrike nuk mund të bëhej ndryshe, veçse duke iu drejtuar tregut ndërkombëtar të këtij malli. Ndryshe nga sa pretenduan kërkuarit, rezultoi se kontraktimi i kapaciteteve për transportimin e energjisë elektrike, me vendim të organizmave të huaja që e dispononin këtë kompetencë, ishte veçuar nga kontraktimi i blerjes së energjisë elektrike, ndërkohë që data e tenderimit për shpërndarjen e kapaciteteve të transportimit të energjisë elektrike ishte e fiksuar përfundimisht. Legjislacioni vendas ekzistues nuk mundësonte blerjen e energjisë dhe transportimin e menjëhershëm të saj në vend. Rregullat e tregut ndërkombëtar dhe afatet e fiksuara prej tij nuk i mundësonin kohën e nevojshme Këshillit të Ministrave, me qëllim ndjekjen e procedurave normale të ligjvënies nga Kuvendi, për të plotësuar

boshllëkun legjislativ të konstatuar. Koha e mbetur në dispozicion nuk i mundësonte qeverisë as kërkimin e ndjekjes së procedurave ligjvënës të përshpejtuara.

Gjykata Kushtetuese konstatoi gjithashtu, se aktet normative me fuqinë e ligjit, pas nxjerrjes së tyre, ishin njoftuar publikisht. Në mënyrë të veçantë, lidhur me to, ishin njoftuar menjëherë subjektet e interesuara. Aktet i ishin përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe ky organ ishte shprehur me ligj për miratimin e tyre, brenda afatit 45-ditor. Ligjet miratuese të Kuvendit, për këtë qëllim, ishin botuar në Fletoren Zyrtare.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese konkludoi se këto akte normative me fuqinë e ligjit janë në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës, prandaj kërkesa për shfuqizimin e tyre duhet rrëzuar.

Në lidhje me aktin normativ me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, përfaqësuesi i kërkuesve riformuloi kërkimin. Ai përfundimisht i kërkoi Gjykatës Kushtetuese të konstatojë pafuqinë juridike të këtij akti, me pretendimin se është miratuar nga Kuvendi tej afatit 45-ditor.

Për shqyrtimin e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese bazohet në konsideratat e shprehura në pjesën e parë të këtij vendimi, ku është trajtuar çështja e fuqisë juridike të aktit normativ me fuqinë e ligjit, si dhe të ligjit që e miraton atë, ku midis të tjerave theksohet: *“Akti normativ me fuqinë e ligjit do të vazhdojë të prodhojë efekte, nëse miratohet, njësoj si gjithë ligjet e tjera por, ai do të humbasë fuqinë juridike që nga fillimi dhe do të konsiderohet se nuk ka ekzistuar kurrë nëse Kuvendi nuk e miraton, ose lejon të kalojë afati 45-ditor pa u shprehur në mënyrë përfundimtare për të. Çdo lloj ndërhyrjeje nga ana e Kuvendit, pas kalimit të këtij afati, është e pavlefshme pasi praktikisht, nuk ekziston më objekti ndaj të cilit mund të bëhet vlerësim. Në mënyrë të qartë Kushtetuta e ka përcaktuar afatin 45-ditor, si një afat prekluziv, që nuk mund të zgjatet për asnjë lloj arsyeje, nga asnjë autoritet. Përfundimi i këtij afati sjell pasojë të menjëhershme për aktin normativ me fuqinë e ligjit, duke e lënë atë pa fuqi që nga fillimi.”*

Bazuar në sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se akti normativ nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” e ka humbur fuqinë e tij juridike që nga fillimi, për shkak se Kuvendi i Shqipërisë nuk është shprehur në mënyrë përfundimtare për të brenda afatit 45-ditor. Arsyet e parashtruara nga pala e interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, për të justifikuar vonesën në shqyrtimin e aktit normativ të qeverisë nga Kuvendi, janë të papajtueshme me Kushtetutën dhe si të tilla nuk mund të justifikojnë miratimin nga Kuvendi tej afatit 45-ditor.

Përsa u takon efektet juridike të përkohshme, që akti normativ nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” krijoi për periudhën nga momenti i miratimit deri në plotësimin e afatit 45-ditor, kanë humbur fuqinë ligjore që nga fillimi dhe konsiderohen sikur nuk kanë ekzistuar asnjëherë.

Për të gjitha këto arsye, kjo kërkesë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të akteve normative me fuqinë e ligjit nr.2, datë 10.11.2005 “Për lejimin e KESH sh.a. të marrë pjesë në ankandet e blerjes së kapaciteteve transmetuese dhe të energjisë elektrike” dhe nr.3, datë 23.11.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.7971, datë 26.07.1995 “Për prokurimin publik” të ndryshuar”.

- Konstatimin e pafuqisë juridike të aktit normativ nr.4, datë 13.12.2005 “Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendimin se për këtë çështje Gjykata Kushtetuese duhej të deklaronte mungesën e juridiksionit të saj për këto arsye:

- Shumica pranon në vendim se në këtë rast duhet të interpretohen elementet përbërëse të nenit 101 të Kushtetutës dhe se çështja lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me parimin e rëndësishëm kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Por, pikërisht për këtë shkak dhe për të zbatuar plotësisht këtë parim, Gjykata Kushtetuese bëhet kompetente pasi të shprehet Kuvendi për miratimin ose jo të aktit normativ me fuqinë e ligjit. Sipas nenit 101 të Kushtetutës, këto akte e humbasin fuqinë që nga fillimi në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi. Prandaj, për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese duhet të presë që të shprehet Kuvendi si organ kompetent dhe pastaj çështja mund t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues.

- Përfashtimi i bërë nga neni 101 (që e analizon shumica) i delegon Këshillit të Ministrave iniciativën ligjvënësë për të nxjerrë akte me fuqinë e ligjit, por dhe në këtë rast, Kuvendi, si organ më i lartë (dhe i vetëm) ligjvënës, ka të drejtën e miratimit ose jo të aktit. Ai nuk e inicon, por e miraton aktin me fuqinë e ligjit dhe si i tillë, ai bëhet pjesë e legjislacionit në fuqi.

- Është fakt që këto akte marrin fuqinë e ligjit kur miratohen. Në praktikën tonë që nga miratimi i Kushtetutës ka me dhjetra raste të ndryshuara me akte të tilla normative (p.sh. Kodi Doganor ka shtesa e ndryshime të rëndësishme). Këto akte, duke u kthyer në ligj dhe në referim të nenit 116 të Kushtetutës që përcakton hierarkinë e akteve normative, do të konsiderohen ligje, atëherë Gjykata Kushtetuese do t'i kontrollojë pasi të jenë miratuar nga Kuvendi.

- Çdo kërkesë e paraqitur para miratimit të aktit normativ nga Kuvendi (si në rastin konkret) nuk duhet të investojë Gjykatën Kushtetuese, ndryshe ajo do të merrte kompetencat e një organi tjetër (Kuvendit).

- Kuvendi, kur miraton ose jo një akt normativ me fuqinë e ligjit, bën dhe interpretimin e nenit 101 të Kushtetutës. Qoftë edhe për këtë shkak, Gjykata Kushtetuese që sipas nenit 124 të Kushtetutës bën interpretimin përfundimtar të saj, nuk mund të shprehet pa vendosur më parë organi përkatës kompetent.

- Shumica shprehet në vendim se Kuvendi, nëse e miraton atë, e kthen në ligj edhe në kuptimin formal. Ky argumentim është i drejtë. Pra, akti normativ kur miratohet nga Kuvendi është ligj në kuptimin material dhe formal. Është pikërisht kjo gjendje që dikton nevojën e shqyrtimit të këtij ligji (akti normativ) nga Gjykata Kushtetuese vetëm pasi të jetë shprehur Kuvendi. Kjo vlen si për miratimin e aktit normativ nga Kuvendi, ashtu edhe për mosmiratimin e tij ose lejimin e kalimit të afatit kushtetues. Në rastin e fundit, akti humbet fuqinë që nga fillimi dhe për akte të tilla nuk mund të bëhet kërkesë e të shqyrtohet çështja nga Gjykata Kushtetuese.

- Shumica shprehet në vendim se aktet normative me fuqinë e ligjit hyjnë në fuqi menjëherë. Ky arsyetim nuk ka bazë. Kushtetuta në nenin 84/4 shprehet se ligji mund të hyjë në fuqi menjëherë në kushte të caktuara dhe vetëm, pasi të jetë njoftuar publikisht. Ky detyrim kushtetues nuk vlen për aktin normativ me fuqinë e ligjit, i cili hyn në fuqi sipas rregullave të përgjithshme të përcaktuara në nenin 117/1 të Kushtetutës. Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrive, të institucioneve të tjera qendrore, marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare.

- Duke u nisur nga ky përcaktim kushtetues lidhur me fuqinë juridike të akteve normative me fuqinë e ligjit, del se ato nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese pa u botuar në Fletoren Zyrtare, pra pa marrë fuqi juridike. Në këtë aspekt del hapur qëndrimi jo konsekuent i mbajtur nga shumica, e cila, nga njëra anë pranon se aktet normative me fuqinë e ligjit i nënshtrohen kontrollit kushtetues edhe para miratimit ose jo nga Kuvendi dhe, nga ana tjetër për hyrjen e tyre në fuqi shprehet se ato duhet të hyjnë në fuqi menjëherë, kur Kushtetuta një rregullim të tillë e ka pranuar vetëm për ligjet në raste të jadhëzakonshme sipas nenit 84/4.

- Sipas formulimit të nenit 101 të Kushtetutës, aktet me fuqinë e ligjit të Këshillit të Ministrave kanë karakter të jashtëzakonshëm dhe të përkohshëm. Ato nxirren nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave si organ që mban peshën e përgjegjësisë politike për qeverisjen e vendit, por njëkohësisht janë akte edhe në kompetencë të Kuvendit, i cili i miraton ose jo. Kjo kompetencë e dyfishtë e këtyre organeve duhet të merret parasysh në shqyrtimin e çështjeve të antikushtetutshmërisë së akteve normative me fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë që Gjykata Kushtetuese, si organ i vetëm i shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit dhe akteve të tjera normative me Kushtetutën, bëhet kompetente vetëm pasi të jenë shprehur të dy këto organe që përcakton Kushtetuta. Në raste të tilla, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese duhet të bëhet edhe për papajtueshmëri me Kushtetutën të ligjit që miraton aktin normativ. Në rast të kundërt, kur akti nuk miratohet nga Kuvendi ose kur kalon afati 45 ditë, akti konsiderohet nul dhe si i tillë nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

Shumica në vendimin e saj është shprehur për fuqinë juridike të aktit normativ nr.4, datë 13.12.2005 "Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën"". Shumica pohon se ai e ka humbur fuqinë e tij që nga fillimi, pasi Kuvendi nuk është shprehur brenda 45-ditëve. Konstatimi nga Gjykata Kushtetuese, përse kohë këtë e ka përcaktuar vetë Kushtetuta, përbën një nonsens.

Përse sipër, jam i mendimit se kjo çështje nuk duhej të merrej në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese.

ANËTAR
K. Peçi

VENDIM
Nr.25, datë 10.11.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 10.4.2006, 3.5.2006, 7.6.2006 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.24 Akti që i përket:

KËRKUES: Zisi Anastasi, Xhemal Muzhaqi, Bukuriye Goga, Xhevrie Demko, përfaqësuar nga avokat Gramoz Çela, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. Frederik Bakalli, përfaqësuar nga avokat Rustem Syziu, me deklaram.
2. Fatos, Astrit, Xhevrije, Sanije Muzhaqi; Fitim, Gezim, Ferdinand Demko; Kostandin, Minella, Ollga Goga; Kasem, Sadete Hyka, Abdyl, Myzejen Bici, në mungesë.
3. Enti i Banesave, dega Durrës, në mungesë.
4. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Durrës, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.49, datë 22.7.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42; 131/f e 134/1, shkronja “g” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të sipërm:

Kërkesa për rishikim është paraqitur brenda afateve ligjore dhe përmban shkaqe të që parashikuara nga neni 498 i Kodit të Procedurës Civile, prandaj Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të kishte pranuar kërkesën për prishjen e vendimit nr.771, datë 25.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe ta dërgonte çështjes për rigjykim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuesve, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesit kanë paraqitur kërkesë në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë për rishikimin e vendimit nr.771, datë 25.5.1998 të Gjykatës së Rrethit Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.970, datë 04.11.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit, ndër të tjera, është vendosur pranimi i kërkesëpadisë së paditësit të kundërpaditur Frederik Bakalli, duke detyruar të paditurit kundërpaditës Zisi Anastasi etj., të njohin trashëgimtarët e trashëgimlënësit Vasil Bakalli, si pronarë të një banese që ndodhet në lagjen nr.1 të qytetit të Durrësit; konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitjes të lidhura midis të paditurve me cilësinë e qiramarrësit dhe Entit të Banesave, si dhe rrëzimin e kundërpadisë së paraqitur nga të paditurit kundërpaditës me objekt, anulimin e vendimit nr.1209, datë 9.3.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë bashkisë Durrës.

Si shkak për paraqitjen e kërkesës për rishikim nga ana e kërkuesve ka shërbyer vendimi nr.348, datë 9.12.2003 i Gjykatës së Apelit Durrës, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr.398, datë 14.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes të cilit Frederik Bakalli deklarohet fajtor për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve në formën e përdorimit dhe në bazë të nenit 186/1 të Kodit Penal, dënohet me 100 mijë lekë gjobë. Me vendimin nr.370, datë 25.06.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur nga i gjykuari Frederik Bakalli.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin që kundërshtohet, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor. Kërkuesit pretendojnë se pikërisht ky vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë duhet të deklarohet si i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi në marrjen e tij janë cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës. Sipas tyre, kërkesa për rishikim duhet pranuar pasi është paraqitur brenda afateve ligjore dhe se ajo

përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 498 i Kodit të Procedurës Civile.

Subjekti i interesuar, përmes avokatit të tij, kërkoi rrëzimin e kërkesës, pasi vendimi që kundërshtohet në Gjykatën Kushtetuese nuk është i papajtueshëm me Kushtetutën. Sipas tij, kërkesa për rishikim është paraqitur jashtë afatit ligjor të parashikuar nga nenet 495 e 496 të Kodit të Procedurës Civile, prandaj mospranimi i saj nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, është një vendim i drejtë që bazohet në Kushtetutë dhe në ligj. Ai vuri në dukje gjithashtu, se pavarësisht nga vendimi penal i dhënë ndaj Frederik Bakallit për falsifikim të dokumentit zyrtar në formën e përdorimit, pronësia e tij dhe e trashëgimtarëve të tjerë të të ndjerit Vasil Bakalli, mbi shtëpinë objekt konflikti, provohet edhe me shumë prova të tjera, përfshirë këtu edhe aktet e pronësisë që nga viti 1915, të cilat i janë paraqitur Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë bashkisë Durrës, dhe më pas edhe gjykatave që kanë shqyrtuar në të tre shkallët konfliktin civil ndërmjet palëve në gjykim.

Referuar pretendimeve të kërkuarit, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa që i është paraqitur asaj duhet të rrëzohet si e pabazuar. Në shqyrtimin e kërkesës për rishikim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk konstatohet asnjë shkelje që do të mund ta bënte këtë proces të parregullt në kuptimin kushtetues. Mospranimi i saj nga ana e këtij kolegj është bërë me arsyetimin e drejtë se ajo është paraqitur jashtë afatit ligjor. Është fakt se vendimi penal ndaj Frederik Bakallit ka marrë formë të prerë në datë 9.12.2003, ndërsa kërkesa për rishikim mban datën 20.2.2004, pra është dërguar në Gjykatën e Lartë pas 73 ditësh nga dhënia e vendimit për këtë çështje nga Gjykata e Apelit Durrës. Sipas nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile, në rastet e parashikuara nga neni 495 i tij, në të cilin hyn edhe çështja në fjalë, afati prej 30 ditësh, brenda të cilit mund të paraqitet kërkesa për rishikim, "... fillon nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë". Pretendimi i kërkuarve se rastësisht janë vënë në dijeni për procesin penal ndaj Frederik Bakallit dhe për vendimet penale që janë dhënë kundër tij nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Apelit Durrës, nuk qëndrojnë. Nga dosja penale nr.762 e prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton se çështja penale në ngarkim të F.B., ka filluar në datë 15.10.2002, pikërisht mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga subjektet e interesuara, Zisi Anastasi etj., një ditë më parë, pra në datë 14.10.2002. Rezulton gjithashtu se ata kanë marrë pjesë aktive me një sërë kërkesesh në shumicën e seancave të zhvilluara për këtë çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në seancën e datës 9.5.2003, Zisi Anastasi ka kërkuar të hyjë edhe si palë në këtë proces, kërkesë që është refuzuar nga trupi gjyqësor i këshilluar në vend.

Gjykata Kushtetuese thekson me këtë rast se përcaktimi i afateve kushtetuese e ligjore në ushtrimin e të drejtës së ankimit, përfshirë këtu edhe të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishikim, nuk është qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të rëndësishëm të sigurisë juridike, si një nga përbërësit themelorë të shtetit të së drejtës. Ky element theksohet edhe në një sërë vendimesh të mekanizmave të ndryshëm ndërkombëtarë të krijuar për garantimin e të drejtave të njeriut.³

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.80, datë 14.11.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË ENERGJISË REAKTIVE PËR SUBJEKTET JOFAMILJARE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar me ligjin nr.9512, datë 10.4.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.109, datë 22.2.2006 "Për normën e lejuar të faktorit të fuqisë", Kodit të Sistemit të Transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.58, datë 28.12.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2006, mbasi

³ Shih vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.1.2000 në Waker kundër Mbretërisë së Bashkuar; vendimin e Komisionit të të Drejtave të Njeriut, datë 17.05.1984 në K.v.Irlandës; vendimin Ndëramerikan të të Drejtave të Njeriut, datë 29.05.2003 në Mendoza v.Argjentinës, etj.

shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “KESH” sh.a., për përcaktimin e çmimeve të energjisë reaktive për subjektet jofamiljare,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë reaktive është 15% e çmimeve të energjisë aktive.
2. Aplikimi i tarifave të energjisë reaktive do të fillojë nga data 1 tetor 2006.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 17.11.2006
Doli nga shtypi më 21.11.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë